REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:018552
Datë: 18.05.2022
Numri i dokumentit: 03027697

P.nr. 106/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuareve **K.K., nga fsh.Veleshe, Komuna e Prizrenit, me mbrojtesin e tije av.H.K., nga Prizreni, dhe M.k., nga fsh.Velezhe, Komuna e Prizrenit**, për shkak të veprës penale pengimi i personave zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore te shtetit në Prizren PP.nr.153-11/2021, të datës 05.02.2021, pas mbajtjes së seancës gjyqesore fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Naim Gashi, të akuzuareve, me datë **14.04.2022**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **K.K.,,** nga i ati **.....**, dhe e ëma **.....**, e vajezerise **.....**, i lindur më datë **.....**në fsh. **.....**, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka te kryer shkollen fillore, punetor, i martuar baba i 3 femijeve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I akuzuari **M.k.,,** nga i ati **.....**, dhe e ëma **.....**, e vajezerise **.....**, i lindur më datë **.....**në fsh. **.....**, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka te kryer shkollen fillore, punetor, i martuar baba i 3 femijeve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë FAJTOR

Te akuzuarit K. e M.k.,

Se me date 10.01.2021, rreth ores 21,30 min, ne fsh. **.....**, Komuna e ne Prizrenit, te pandehurit K. dhe M.k.,, duke vepruar ne bashkeveprim me dashje, tentojne qe ti pengojne personat zyrtar ne kryerjen e detyres zyrtare, ashtu qe Policia e Kosoves, gjate nje kontrolli

2021:265535

rutinor te bere ne fsh. **.....**, veren duke punuar lokalin e te pendehurit M.k.,, i cili bashke me te pandehurin K.K., dhe i demtuari-zyrtari policor E.S., bga te njejtit kerkon leternjoftimet per ti legjitimiuar, te njejtit refuzojne qe te legjitimohen, duke mos iu bindur urdherave policore, dhe me pas i pandehuri K.K.,, iu drejtohet zyrtarit policor te lertecekur me fjalet" une nuk ju tutna juve, as mos mendoni qe po me tutni, keni me pa, keni mi ra pishmane per kete pune", dhe i cili gjate arrestimit reziston duke shtyre me duar dhe kembe te demtuarin i cili, me pas arrestohet nga ana e policise, dhe me pas i pandehuri M.k.,, duke verejtur se eshte duke u arrestuar i pandehuri K., i afrohet te demtuarit-zyrtarit policor E.S., duke e kapur te njejtin per jakne, duke e terhequr zvarre, si dhe duke per dorur fjale ofenduese, ku i cikli me pas arrestohet nga ana e policise, dhe si rrjedhoje e ketyre veprimeve tenjejtit tentojne te pengojne zyrtarin policor qe i njejti te mos i kryeje detyrat e tije zyrtare te percaktuara me ligj.

-Kësodore ne bashkekryerje kane kryer vepren penale pengimi i personave zyrtar gjate kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 71, 72, te KPK-se, dhe nenit 401 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 te KP-se, si dhe nenit 365 te KPPK-es te akuzuarit i:

GJYKON

Te akuzuarit K.K., i shqipton:

D E N I M M E B U R G I M

Ne kohezgjatje prej 8 /tete/ muajve, i cili denim do te ekzekutohet 15 dite pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi,

Te akuzuarit M.k., i shqipton:

D E N I M M E B U R G I M

Ne kohezgjatje prej 8 /tete/ muajve, i cili denim do te ekzekutohet 15 dite pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi,

Te akuzuarit obligohen që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, në emër të paushallit gjyqsor shumën secili veq e veq me nga **30 Euro,** si dhe ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit secili veq e veq shume me nga **30 euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kercnim te ekzekutimit te dhunshem.

I demtuari E.S., nga **.....**-Prizren, lagjja **.....**pnr, per relizimin e kerkeses pasurore-juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik

A r s y e t i m

2021:265535

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP.nr.153-11/2021 te dt.05.02.2021, kunder te akuzuareve K.K., e M.k., qe te dy nga fsh. **.....**, Komuna e Prizrenit, per shkak te vepres penale pengimi i personave zyrtare ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1e lidhur me nenin 31 te KP-se,

Gjykata ne rigjykim ne shqyrtim kryesor gjyqesor, pas veretjeve te Gjykates se Apelit ne Prishtine me aktvendimin PA1.nr.1596/2021 te dt.20.01.2022, duke vepruar dhe i eliminuar verejtjet sipas aktvendimit te lartecekur, dhe ate duke i spjeguar, interpretuar dhe kuptuar nga ana e te akuzuareve institutin juridik te pranimit te fajesise, dhe pas konsulltave te te akuzuarit K.e K....., me mbrojtesin e tije av.H.K.,, ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi vullnetar i fajesise nga ana e te akuzuareve te cilet vullnetarisht e kane pranuar fajsine, pa kurfare ndikimi e as imponimi, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka verteuar se te akuzuarit kane kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila iu vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat te akuzuarit kane qene te njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhe ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuareve eshte bere ne pajtim me nenin 248 par.1 nenpar.1.1, 1.2 e 1.3 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuareve formohen te gjitha elementet e vepres penale, pengimi i personave zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 te KPK-se, dhe per kete gjykata te akuzuarit e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me burgim si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tyre penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuareve gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 69 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke i gjetur rrethanat posaqerisht renduese, pergjegjesine penale, te akuzuarit vepren penale e kane kryer me dashje, duke i penguar dhe mos u bindur urdherave te personave zyrtar si institucione shteterore-zyrtareve policore, dhe te njejtine duke i kapur per uniforme-jakne dhe terheq zvarre, e ne kuptim te nenit 70,71,72, gjykata mori parasysh si rrethane lehtesuese per baze edhe faktin se te akuzuarit kane bashkepunuar me gjykaten, bashkepunimi i tyre ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, kane shprehur keqardhje per vepren penale te kryer, kane kane kuptuar rendesin dhe pasojat e pranimit te fajesises, dhe e kane pranuar vullnetarisht fajesine pa kurfar presioni e as ndikimi, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tyre, punetor, mbajtes te familjeeve me nga 5 anetare, me te demtuarin duke i kerkuar falje publike deshirojne ta gjejne gjuhen e pajtimit dhe te mirekuptimit, do ti kompenzojne demin moral-material te shkaktuar, premtojne se ne te ardhmen nuk do te perserisin vepra te penale te kesaj natyre, gjer me tani te pagjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata iu shqiptoi denimin me burgim, sepse konsideron se me me kete mase sankcionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tyre dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jene te kujdesshem dhe do te permbahen nga veprimet e tilla te karakterit penalo-juridik, dhe se i njejti denim te te akuzuarit do te ndikoje ne risocializimin e tyre qe ne te ardhmen te jene me te kujdesshem dhe ti respektojne institucionet policore.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

2021:265535

Deparatamenti i pergjithshem penal
P.nr.106/2022 të datës 14.04.2022

Sekretare Juridike **Gjyqtari**
Fatime Bajraktari **Fatmir Krasniqi**

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.

2021:265535